
	<b>KODI I ETIKËS DHE QEVERISJES KORPORATIVE PËR NPQ</b>	<b>PO-KO-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 9</i>
<i>Departamenti:</i>		<i>Sektori:</i>

**KODI I ETIKËS DHE QEVERISJES KORPORATIVE  
PËR NPQ  
“OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE  
TREGU” – KOSTT SH.A**

	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	<b>Merita Kostari</b>	Safete Orana	Bordi i Drejtorëve
Nënshkrimi			
Data			16. Qershor 2009

	<b>KODI I ETIKËS DHE QEVERISJES KORPORATIVE PËR NPQ</b>	<b>PO-KO-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 9</i>
<i>Departamenti:</i>		<i>Sektori:</i>

## SEKSIONI I

### OBJEKTIVAT DHE PRAKTIKAT

#### 1. Të përgjithshme

(a) Ky Kod për Qeverisjen e Korporatës (“Kodi”) ka për qëllim të promovojë praktikat efikase dhe të përgjegjshme për qeverisjen e korporatës: NP “Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu”- KOSTT Sh.A. Në këtë kuptim, Kodi duhet të paraqesë kriteret që, do të zbatohen nga organet e Kompanisë, ushtrojnë lirinë e veprimit, e cila u lejohet atyre me statut dhe Ligj të Zbatueshëm.

(b) Ky Kod duhet të lexohet në lidhje me kornizën rregullative të korporatës, e aplikueshme në Republikën e Kosovës, për të përfshirë Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr. 2008/03-L-087, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare Nr. 2007/02-L-123 (ashtu siç është nxjerrë nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2008/26) dhe statutet e Kompanisë, ashtu siç plotësohet kohë pas kohe. Nëse ndonjë prej dispozitave në këtë Kod është në konflikt me dispozitat e dokumenteve të lartpërmendura, atëherë mbizotërojnë dokumentet e më parme.

(c) Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në statutin e Kompanisë do ta kenë të njëjtin kuptim dhe efekt atëherë kur përdoren në këtë Kod, vetëm në rast se shprehet ndryshe ose nëse konteksti e kërkon ndryshe.

#### 2. Natyra obliguese dhe interpretimi.

Ky Kod do të jetë i detyrueshëm për Kompaninë, veçanërisht për Bordin e saj të Drejtorëve, Komitetin e Auditit dhe Zyrtarët.


## SEKSIONI II

### RAPORTI MIDIS ZYRTARËVE DHE BORDIT

#### 3. Përzgjedhja e Zyrtarit të Lartë Ekzekutiv (ZLE)

(a) ZLE-ja i Kompanisë do të përzgjidhet vetëm në bazë të meritës, veçanërisht, Bordi i Drejtorëve duhet të përzgjedhë një kandidat që posedon aftësi për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj; i cili është i gatshëm dhe ka mundësi të implementojë strategjinë e përcaktuar nga Bordi i Drejtorëve dhe i cili ka aftësi të japë mendim e tij objektiv dhe të pavarur në lidhje me interesin e veçantë të Kompanisë.

Në këtë pikë, ZLE-ja i Kompanisë duhet të përzgjidhet përmes një procesi konkurrues të hapur dhe transparent, i organizuar si vijon:

	<b>KODI I ETIKËS DHE QEVERISJES KORPORATIVE PËR NPQ</b>	<b>PO-KO-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 9</i>
<i>Departamenti:</i>		<i>Sektor:</i>

(i) Bordi i Drejtorëve do të përcaktojë kualifikimet minimale dhe të kërkuara për pozitën; kualifikimet e tilla duhet të jenë specifike dhe të lidhura me nevojat e Kompanisë dhe sektorin në të cilin ajo operon;

(ii) Shpallja e arsyeshme informative për vend të lirë pune duhet të publikohet dy herë në së paku dy prej gazetave më të lexuara kosovare, dhe duhet të shpërndahet nëpërmjet mediave të tjera në Kosovë dhe më gjerë;

(iii) Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve nuk duhet të jetë më i shkurtër sesa një muaj që nga data e publikimit të shpalljes së parë për vend të lirë pune;

(iv) Bordi i Drejtorëve duhet të udhëzojë një këshilltar të pavarur, kompetent dhe me reputacion që të vlerësojë të gjithë kandidatët kundrejt kërkesave minimale dhe të krijojë një listë të ngushtë sipas kualifikimeve të tyre profesionale;

(v) Bordi i Drejtorëve duhet të vlerësojë dhe intervistojë një numër të mjaftueshëm kandidatësh (zakonisht, jo më shumë se 4);

(vi) Procesi i përzgjedhjes duhet të përsëritet derisa Bordi i Drejtorëve të identifikojë një kandidat të kënaqshëm.


(b) Kandidati i zgjedhur duhet të ketë besueshmërinë e plotë të Bordit të Drejtorëve.

(c) Ngjashëm, ZLF-ja dhe Sekretari/Këshilltari i Përgjithshëm do të përzgjidhen nga ZLE-ja vetëm në bazë të meritës. Në këtë kuptim, kandidatët do të propozohen nga ZLE-ja për t'u emëruar më pas nga Bordi i Drejtorëve. Përzgjedhja do të bëhet përmes një procesi konkurrues dhe transparent, i krijuar lirshëm nga ZLE-ja mbi bazë të analizës së kostove-përfitimeve, dhe në pajtim me politikat e Kompanisë për rekrutim dhe në pajtim me Ligjin e Zbatueshëm.

#### **4. Kompetencat e Bordit të Drejtorëve, ZLE-së dhe ZLF-së**

(a) Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se ZLE-ja gëzon fuqinë e mjaftueshme për menaxhimin koherent të afarizmit dhe detyrave të Kompanisë, duke pasqyruar përgjegjësinë e madhe të ZLE-së për performancën e Kompanisë. Në veçanti, Bordi i Drejtorëve nuk duhet të ndërhyjë, ose të sfidojë vendimet e ZLE-së, sa i përket rekrutimit ose përjashtimit të punëtorëve të Kompanisë, ose niveleve të tyre të pagave (tjetër nga ajo e Zyrtarëve të Kompanisë). Përveç kësaj, anëtarët e Bordit nuk duhet t'u japin udhëzime punëtorëve të Kompanisë për çështjet që i përkasin Kompanisë, në rast se ata nuk veprojnë në kapacitetin e tyre si konsumatorë të Kompanisë. Me kusht që Bordi, si organ grumbullues, dhe i nënshtrohet dispozitave të këtij Kodi dhe statutit të Kompanisë, mund të u japë udhëzime Zyrtarëve të Kompanisë.

(b) Bordi i Drejtorëve do të i kufizojë brenda kompetencave të veta – përmes kërkesës për autorizimin e tij paraprak – vetëm vendimet për veprimet ose transaksionet më të rëndësishme, të cilat parashtrajnë rreziqe për strukturën industriale ose financiare të Kompanisë, duke i identifikuar ato mbi bazat e natyrës dhe masave të tyre; transaksionet e tilla natyrisht do të përfshijnë përvetësimin dhe shitjen e bizneseve të mëdha ose degëve të tyre, të cilat përfaqësojnë

	<b>KODI I ETIKËS DHE QEVERISJES KORPORATIVE PËR NPQ</b>	<b>PO-KO-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 9</i>
<i>Departamenti:</i>		<i>Sektori:</i>

së paku 10% të qarkullimit vjetor të Kompanisë, gjetjen e garantuesve për detyrimet e mëdha dhe detyrimet e tjera të hapura të palës së tretë, krijimin e kredive të mëdha ose ndonjë forme tjetër të zgjatjes së kredisë, e cila e vë Kompaninë para rreziqeve të mëdha, dhe ndonjë transaksion, vlera e të cilit tejkalon 10% të qarkullimit vjetor.

(c) Në çdo rast, Bordi i Drejtorëve do të ruajë kompetencën për të marrë vendime ose për të autorizuar çështjet që bien brenda menaxhimit ditor të Kompanisë.

(d) Bordi i Drejtorëve nuk do të shqyrtojë në detaje veprimet ose vendimet që bien brenda menaxhimit ditor të Kompanisë, me përjashtim të detyrave të saj për mbikëqyrje.

(e) Bordi i Drejtorëve mund të kufizojë kompetencat e ZLE-së duke kërkuar nënshkrimin e ZLF-së vetëm në vendimet që kanë të bëjnë me veprimet ose transaksionet, të cilat derisa janë të një madhësie të konsiderueshme (në kriterin e njëjtë të paraqitur në seksionin II.4(b) më sipër), nuk krijojnë rreziqe të mëdha për strukturën financiare dhe industriale të Kompanisë.

(f) Bordi i Drejtorëve do të sigurojë që ZLE-ja të gëzojë kompetencën e mjaftueshme për të menaxhuar në mënyrë koherente çështjet financiare të Kompanisë. Bordi do t'i kufizojë të drejtat e ZLE-së vetëm në rast të marrjes së këtyre kompetencave për vete brenda kufijve të përcaktuar në seksionin II.4(b) të Kodit ose në rast të kërkesës për nënshkrim të përbashkët me ZLE-në.

(g) Bordi i Drejtorëve vendos që t'ia japë ZLE-së udhëzimet për organizimin e brendshëm të Kompanisë, këtij të fundit nuk do t'i kufizohet liria e veprimit për të modeluar raportimin e drejtpërdrejtë, që çon te ZLE-ja. Në çdo rast, Bordi i Drejtorëve mund të vendosë të mos ia japë ZLE-së udhëzimet e detajizuara për organizimin e brendshëm të Kompanisë.

## 5. Detyrat e mbikëqyrjes së Bordit të Drejtorëve


(a) Bordi i Drejtorëve do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze, veçanërisht mbi sjelljen e Zyrtarëve të Kompanisë (duke përjashtuar Zyrtarin e Brendshëm për Auditim, i cili është në kompetencë ekskluzive të Komitetit të Auditit).

(b) Nëse performanca e Kompanisë i shmanget synimeve të vendosura në planin e biznesit të vitit të caktuar financiar, atëherë Bordi i Drejtorëve do të kërkojë një raport nga ZLE-ja, ku do të tregohen arsyet dhe sqarimet për mosfunksionim të duhur, dhe do të merren masat e duhura përmirësuese.

(c) Në rast se Kompania nuk i përmbush synimet e saj realizuese për dy vite financiare radhazi, Bordi i Drejtorëve do ta heq dhe zëvendësojë ZLE-në, madje edhe në rast të mungesës së dëshmimeve të qarta të neglizhencës, me përjashtim të rastit kur del se mosrealizimi ka qenë rezultat i rrethanave ose ngjarjeve të paparashikuara në mënyrë objektive.

## 6. Fuqizimi i detyrave të dhëna në mirëbesim të Zyrtarëve

(a) Kurdo që informacionet e besueshme dëshmojnë se ndonjë prej Zyrtarëve (duke përjashtuar Zyrtarin e Jashtëm për Auditim, i cili është në kompetencë ekskluzive të Komitetit të Auditit) ka

	<b>KODI I ETIKËS DHE QEVERISJES KORPORATIVE PËR NPQ</b>	<b>PO-KO-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 9</i>
<i>Departamenti:</i>		<i>Sektori:</i>

vepruar në kundërshtim me detyrat e tij të besueshme, atëherë Bordi i Drejtorëve do ta hulumtojë çështjen pa vonesë.

(b) Nëse Bordi i Drejtorëve zbulon se një prej detyrave të besueshme të zyrtarit është shkelur, atëherë ai duhet ta largojë dhe zëvendësojë menjëherë këtë të fundit, dhe do të kërkojë dëmshpërblim kundër tij/saj.

### SEKSIONI III

#### TAKIMET E BORDIT DHE KOMITETIT TË AUDITIT

##### 7. Takimet e Bordit të Drejtorëve

(a) Bordi i Drejtorëve do të krijojë një orar të rregullt të takimeve të tij të zakonshme, të cilat parashihen të jenë jo më pak se 6 dhe jo më shumë se 12 takime në vit, të cilat do të mbahen në intervale të rregullta mujore. Bordi i Drejtorëve duhet të krijojë rezolutat me shkrim, në pajtim me statutin përpos atëherë kur justifikohet në mënyrë objektive, se mbajtja e një takimi urgjent është e pazbatueshme.

(b) Në secilin takim të zakonshëm, Bordi i Drejtorëve do të shqyrtojë dhe diskutojë së paku gjendjen financiare dhe performancën afariste të Kompanisë, implementimin e planit të biznesit, planin e investimeve dhe raportet e ZLE-së për transaksionet, vendimet dhe ngjarjet e periudhës përkatëse.


(c) Kryetari i Bordit të Drejtorëve do t'i shqyrtojë me kujdes dokumentet e dorëzuara për Bordin e Drejtorëve, para takimit, në mënyrë që të jetë në gjendje të kërkojë sqarime ose informacione të tjera nga ZLE-ja.

(d) Takimet e jashtëzakonshme të paplanifikuara do të mbahen vetëm atëherë kur thirren. Atëherë kur çështje të rëndësishme dhe urgjente kërkojnë zgjidhje nga Bordi i Drejtorëve dhe çështja nuk mund të presë deri në takimin e planifikuar të radhës. Rendi i ditës për takimet e jashtëzakonshme duhet të thirren mbi çështjen(et) që ngrihen në takim.

##### 8. Komiteti i Auditit

(a) Zyrtari i Brendshëm për Auditim do të përzgjidhet në bazë të meritës. Në mënyrë specifike Komiteti i Auditit duhet të përzgjedhë kandidatët që posedojnë aftësitë dhe shkathtësitë e duhura për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tyre. Përzgjedhja do të bëhet nëpërmjet një procesi konkurrues dhe transparent, i krijuar lirshëm nga Komiteti i Auditit mbi bazë të analizës së kostove dhe përfitimeve, dhe në pajtim me politikat për punësim të Kompanisë dhe Ligjin e Zbatueshëm.

(b) Mbikëqyrja e Zyrtarit të Brendshëm për Auditim do të bëhet në pajtim me, *mutatis mutandis*, rregullat e njëjta të vendosura në seksionin II.5 të këtij Kodi.

	<b>KODI I ETIKËS DHE QEVERISJES KORPORATIVE PËR NPQ</b>	<b>PO-KO-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 6 nga 9</i>
<i>Departamenti:</i>		<i>Sektori:</i>

(c) Pagat e propozuara për ZLE, ZLF, Zyrtarin e Brendshëm për Auditim dhe Sekretarin/Këshilltarin e Përgjithshëm do të vendosen nga Komiteti i Auditit – në konsultim me ZLE-në, në lidhje me pagën e ZLF-së dhe Sekretari i Korporatës/Sekretari i Përgjithshëm – brenda niveleve të pagave në treg, dhe – në ndonjë rast– në nivelin që nuk dëmtohet mundësia e Kompanisë për të tërhequr kandidatë që kanë aftësitë dhe kompetencat e duhura.

(d) Komiteti i Auditit do të takohet para secilit takim të Bordit të Drejtorëve, së paku tre ditë më herët, dhe do të caktojë takimet në përputhje me rrethanat. Përveç kësaj, Komiteti i Auditit do të caktojë çdo takim shtesë, i cili mund të kërkohet për përmbushjen e detyrave të tij.

(e) Në secilin takim që do të mbahet para takimeve të Bordit të Drejtorëve, Komiteti i Auditit do të shqyrtojë – përveç dokumenteve të përgatitura nga ZLE për Bordin e Drejtorëve – raportet nga Zyrtari i Brendshëm për Auditim lidhur me çështjet e caktuara që bien brenda kompetencave të tij.

(f) Kryetari i Komiteti të Auditit do të shqyrtojë me kujdes dokumentet e dorëzuara nga Zyrtari i Brendshëm për Auditim te Komiteti i Auditit, para mbajtjes së takimit, në mënyrë që të jetë në gjendje të kërkojë sqarime ose informacione të tjera nga Zyrtari i Brendshëm për Auditim.

(g) Takimet e paplanifikuara ose të jashtëzakonshme do të mbahen vetëm kur thirren, kur çështje të rëndësishme dhe urgjente kërkojnë një vendim nga Komiteti i Auditit dhe çështjet që nuk mund të presin deri në takimin e planifikuar të radhës. Rendi i ditës për takimet e jashtëzakonshme duhet të thirren mbi çështjen(et) për të cilat edhe është thirrur ai takim.

(h) Për ta lehtësuar ushtrimin e mandatit të tij, Komiteti i Auditit mund të kërkojë edhe një konsultat të jashtëm, si këshilltar. Këshilltari i jashtëm duhet të ketë përvojë të duhur ndërkombëtare në praktikën e financave dhe kontabilitetit, bashkë me njohurinë mbi praktikën më të mira për auditim.


(i) Komiteti i Auditit do të adaptojë rregullat procedurale për trajtimin konfidencial të informacioneve të mbledhura si rezultat i programit për denoncim, për shkak të hulumtimeve dhe trajtimit të akuzimeve të pavërteta.

## SEKSIONI IV

### DISPOZITA TË NDRYSHME

#### 9. Vetëvlerësimi i performancës së Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditit .

Bordi i Drejtorëve dhe Komiteti i Auditit do të shqyrtojnë performancën e tyre për çdo vit, në pajtim me kriteret për vlerësim, të krijuara në fillim të vitit financiar, dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit të Zbatueshëm.

	<b>KODI I ETIKËS DHE QEVERISJES KORPORATIVE PËR NPQ</b>	<b>PO-KO-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 7 nga 9</i>
<i>Departamenti:</i>		<i>Sektori:</i>

## 10. Deklarimi.


Bordi i Drejtorëve do të adaptojë, bashkë me pasqyrat financiare vjetore, një përmbledhje të shkurtër, dhe një raport të thjeshtë gjuhësor, duke përmbledhur në mënyrë të qartë, të drejtë dhe koherente pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë dhe raportin vjetor, duke u përqendruar në të dhënat kryesore, ngjarjet dhe vendimet e vitit përkatës financiar. Një raport i tillë do të përgatitet nga ZLE-ja, do t'i dorëzohet Komitetit të Auditit, do t'i dorëzohet për aprovim Bordit të Drejtorëve dhe do të publikohet në uebsajtin e Kompanisë, bashkë me pasqyrat vjetore financiare.

## 11. Kodi i Etikës, Politikat për Staf dhe Udhëzuesi i Punëtorëve.

(a) ZLE-ja do të paraqesë para Bordit të Drejtorëve një udhëzues për punëtorë, i cili duhet të përfshijë kodin e etikës dhe politikat për staf, ashtu që në mënyrë kolektive të sigurohet se Kompania po i zbaton praktikat e qeverisjes së përgjegjshme dhe efikase në të gjitha fushat përkatëse.

(b) Secili Bord i Drejtorëve kërkohet të respektojë dispozitat e zbatueshme të udhëzuesit të punëtorëve të Kompanisë. Me kusht që, politikat vijuese të Kompanisë janë të detyrueshme dhe të obligueshme për secilin anëtar të Bordit:

- (i) Logot dhe mbishkrimet e Kompanisë nuk duhet të përdoren për letra personale ose për ndonjë qëllim jozyrtar të Kompanisë.
- (ii) Armët, duke përfshirë thikat, armët e zjarrit ose eksplozivët, nuk janë të lejuara në objektet e Kompanisë.
- (iii) Bordi i Drejtorëve nuk duhet të pranojë të holla ose dhurata, materiale ose trajtime apo favorizime të tjera të veçanta, të cilat mund të krijojnë, ose duket se krijojnë, një pozitë favorizuese për dikë që bën biznes me Kompaninë, duke përfshirë çdi individ, entitet afarist, ose agjencion, i cili është në pozitë për të ofruar mallra ose shërbime për Kompaninë. Me qëllim të këtij Seksioni, “dhuratë” përcaktohet çdo gjë që ka vlerë, duke përfshirë edhe drekat dhe darkat; biletat e fluturimit ose akomodimet në hotele, ose format e tjera të argëtimit. Kjo listë nuk ka për qëllim që të jetë ekskluzive.
- (iv) Besueshmëria: Gjatë mandatit të një anëtari të Bordit, ai/ajo do të jetë konfidencial ndaj informacioneve të Kompanisë, që kanë të bëjnë (por jo edhe të kufizohen në) me: dizajnet e produkteve, të dhënat për personelin e kompanisë, parashikimet e ngarkesave, planet për kapacitet, dosjet e tarifave, strategjitë për marketing, informacionet për konsumatorë, politikat për caktimin e çmimit, dhe informacionet e tjera të lidhura me këto. Këto informacione janë pronësore dhe kritike për suksesin e Kompanisë dhe duhet mos të dalin ose të përdoren jashtë objekteve të Kompanisë ose të diskutohen me ndonjë punëtorë jashtë Kompanisë, vetëm në rast se kjo lejohet nga ZLE-ja ose kur kërkohet me Ligj të Zbatueshëm. Ky obligim do të vazhdojë edhe pasi të ketë përfunduar ose përjashtuar mandati i anëtarit të Bordit.
- (v) Marrëdhëniet me Publikun: meqë Kompania duhet të flasë në një mënyrë të koordinuar dhe konsistente, vetëm punëtorët e Kompanisë, të cilët janë të autorizuar

	<b>KODI I ETIKËS DHE QEVERISJES KORPORATIVE PËR NPQ</b>	<b>PO-KO-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 8 nga 9</i>
<i>Departamenti:</i>		<i>Sektori:</i>

me shkrim nga ZLE-ja mund të flasë para mediave lidhur me çështjet që i takojnë Kompanisë. Të gjitha komunikimet me shkrim, me media, do të përgatiten nga Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun dhe do të aprovohen nga ZLE-ja para se këto komunikime me shkrim të dorëzohen në media. Sipas kësaj, dhe në pajtim me këtë politikë, anëtarët e Bordit duhet të mos flasin, ose të dorëzojnë komunikata me shkrim, për media, lidhur me gjërat që i përkasin Kompanisë.

(c) Anëtarët e Bordit caktohen me paga dhe përfitime vetëm nga Kompania, ashtu siç parashihet me Ligjin e Zbatueshëm. Në këtë pikë, dhe sipas dispozitave të Seksionit III.8 (h) të këtij Kodi, Kompania nuk do t'ju sigurojë (dhe anëtarët e Bordit nuk duhet ta kërkojnë) këshilltarë, vetura, kompjuterë, telefonë ose pajisje të tjera ose përfitime për Bordin e Drejtorëve, e as t'u sigurojë ndonjë zyrë brenda objekteve të Kompanisë. (përveç për qëllime të mbajtjes së takimeve të Bordit ose takimeve të Komitetit të Auditit).

Ky Kod do të hyjë në fuqi më datën e paraqitur më poshtë dhe do të publikohet në uebfaqen e Kompanisë.


## BURIMET DHE DOKUMENTET

### Burimet

Nr.	Emri i dokumentit
1.	
2.	
3.	
4.	
5.	

### Dokumentet dhe formularët



	<b>KODI I ETIKËS DHE QEVERISJES KORPORATIVE PËR NPQ</b>	<b>PO-KO-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 9 nga 9</i>
<i>Departamenti:</i>		<i>Sektori:</i>

## LISTA E SHPËRNDARJES DHE HISTORIKU

### Lista e shpërndarjes

Nr.	Emri dhe mbiemri	Data	Nënshkrimi
1.	Ramadan Paçarada		
2.	Merita Kostari		
3.	Kimete Fazliu		
4.	Personeli: G:/SMC ISO 9001/KO-/PO-KO-001		
5.			
6.			
7.			
8.			
9.			
10.			

### Shënime për versionet

Versioni	Data	Përshkrimi	Kohëruajtja
1.0	PO-KO-001	Versioni Inicial	5 Vite